



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

---Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 73/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Vedat Poterqoi - Kryetarë, Vjosa Gradinaj Mexhuani-Anëtare dhe Agon Ramadani-Anetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Internat Security Association" sh.p.k, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Sigurimi fizik i objektit te MSH-se dhe depos se barnave" me nr. të prokurimit:206-22-11504-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Shëndetësisë, me datë 23.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. **Hedhet si e palejuar**, ankesa e operatorit ekonomik "Internat Security Association" sh.p.k, me seli në Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 10.02.2023 me numër protokollit 73/2023, për aktivitetin e prokurimit: Sigurimi fizik i objektit te MSH-se dhe depos se barnave" me nr. të prokurimit:206-22-11504-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Ministria e Shëndetësisë, si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.

2. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 25.01.2023, ka publikuar Vendimin e AK-së për dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objektit të MSH-së dhe depos së barnave” me nr. të prokurimit:206-22-11504-2-1-1, për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Rojet e Nderit sh.p.k” me seli në Prishtinë.

Kërkesa për ri shqyrtim e OE ankues “Internat Security Association” sh.p.k me datë 30.01.2023, si dhe vendimi për refuzim të kërkesës për ri shqyrtim nga AK 31.01.2023.

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, OE “Internat Security Association” sh.p.k me datën 10.02.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP me numër të protokollit 73/23.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 170,000.00 €.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 28 shkurt 2023 ka rekomanduar që:

- Refuzohet si e pa bazuar ankesa e “Internat Security Association” sh.p.k, me seli në Prishtinë
- Të mbetet në fuqi vendimin e AK-së i datës 25.01.2023(*vendim për dhënie të Kontratës*)

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE “Internat Security Association” sh.p.k, me seli në Prishtinë .

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues ne ankesën e dorëzuar në OSHP si dhe deklaratën detale mbi faktet dhe argumentet e paraqitura Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, shërbim, kontrate kornizë me një Operator për periudhën prej 36 muajsh.

Sa i përket pretendimit te OE ankues eksperti shqyrtues sqaron se përkundër faktit se OE ankues i referohet kërkesës se dosjes se tenderit nenit 2.1 për minimumin e kërkesave për punëtor është 10, ne përshkrimin e çmimeve të bashkangjitur në sistemin e prokurimit përlllogaritja e numrit të punëtorëve bëhet për 8 pozita.

Po ashtu në bazë të formularit për korrjigjimin e gabimeve të datës 21.10.2022 AK-ja kishte shtuar buxhetin nga 140,000.00 ne 170,000.00 euro.

Nga tabela e çmimeve të bashkangjitura në e prokurim rezulton se të gjitha ofertat e dhëna nga të gjithë Operatorët Ekonomik e plotësojnë kriterin e pagesës se pagës minimale sipas Ligjit të PunesNr.03 L-212.

Duke pas parasysh Ligjin e Punës eksperti shqyrtues konstaton se llogaritja e AK-se në bazë të listës së çmimeve të bashkangjitur në dosjen e tenderit është në përputhje me Ligjin e Punës, përjashtuar këtu mënyrën e përlllogaritjes dhe se rezulton se të gjitha ofertat e dorëzuara në këtë procedure të prokurimit janë brenda kufirit të kërkuar sipas dosjes së tenderit për pagesën e pagës minimale.

Pjesa nr.	Emri i punës (A)	Sasia (B)	Çmimi i orarit (C)	Sasia totale e orëve të punës (D)	Sasia totale e orëve të punës të kërkuara (E)	Çmimi për orë punë (F)	Çmimi për orë punë (G)	Çmimi total për punë (H)	Çmimi total për punë (I)	Çmimi për orë punë (J)
1	Sqarimi fiskal - ne objektit të MSH-së	2	1000 (1000.00.00)	10	10	18.00	2.21	574.56	677.70	24,207.31
2	Sqarimi fiskal - tek porta kryesore - objektit të MSH-së	1	8000 (8000.00.00)	8	240	1.87	2.21	148.95	529.58	19,265.01
3	Sqarimi fiskal - tek porta kryesore - objektit të MSH-së	1	8000 (8000.00.00)	8	240	1.87	2.21	148.95	529.58	19,265.01
4	Sqarimi fiskal - tek porta kryesore - objektit të MSH-së	1	8000 (8000.00.00)	8	240	2.10	2.48	384.00	594.72	21,409.01
5	Sqarimi fiskal - ne Depozituesit të Barnave	1	8000 (8000.00.00)	8	240	1.87	2.21	148.95	529.58	19,265.01
6	Sqarimi fiskal - ne Depozituesit të Barnave	1	8000 (8000.00.00)	8	240	1.87	2.21	148.95	529.58	19,265.01
7	Sqarimi fiskal - ne Depozituesit të Barnave	1	8000 (8000.00.00)	8	240	2.10	2.48	384.00	594.72	21,409.01
TOTALI (1-7)										143,487.28

Duke u bazuar në përlllogaritjen si më lartë eksperti shqyrtues konstaton se përlllogaritja e pozicioneve është bërë për 8 vende pune përkundër faktit se OE ankues i referohet 10 vendeve të punës. Pozicioni i parë është i përlllogaritur për 2 pozita të cilat janë me orarë të rregullt të punës.

Pozicionet të cilat janë me çmim njësi 2.21 janë pozicione që kanë të bëjnë me orarë të rregullt por edhe me pune jashtë orarit e të cilat kur janë kalkuluar e përbejnë çmimin e përshkruar më lartë. Çmimi njësi është nxjerr si çmim mesatar për komplet orët e punës sipas tabelës së çmimeve.

Ndërsa pozicionet e mbetura janë pozicione të cilat shumicën e orëve të punës e kanë pune të natës ndërsa me pak orë janë orë të rregullta. Totali i orëve të nxjerra në tabelë është mesatarja e përgjithshme e orëve për muaj.

Vlen të theksohet se përlllogaritja është marrë me pagesën e kushtëzuar sipas dosjes së tenderit 265 € neto apo 288.11 € bruto.

Prandaj Bazuar në përlllogaritjen AK-ja ka vepruar drejt.

Përfundim:

Eksperti shqyrtues pas analizimit të pretendimit të Operatorit Ekonomik ankues vlerëson se pretendimi është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësit e tyre dhe ekspertiza e ekspertëve shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Duke i analizuar pretendimet e ankuesit, përmbajtjen e tyre dhe raportin e ekspertit shqyrtues Paneli Shqyrtues konsideron se:

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës. Sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës, apriori pretendimet ankimore nuk konsistojnë në faktin nëse është atakuar apo jo interesi ekonomik i Ankuesit. Prandaj parashtruesi i ankesës nuk mund ta ketë statusin e palës me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se, tenderi i ofruar nga OE ankues sipas shumës së ofruar është i radhitur i 5 (pesti) me radhë në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, i njoftuar zyrtarisht nga AK me anë të letrës standarde për tenderuesin e pa-suksesshëm dhe me anë të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e tij e atakon vetëm të rekomanduarin e nuk e argumenton pohimin se operatorët tjerë të radhitur para tij nuk janë të përgjegjshëm, ndërsa OE të cilët janë të radhitur para tij, janë më të lirë për nga çmimi dhe janë të përgjegjshëm.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, "Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("palë e interesuar") në nenin 4 të këtij ligji". Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritore të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP.

- Përfundim -

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësisht ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit të prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve

ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Vendimi sikurse në pikën 2, të dispozitivit është marrë në kuptim se njoftimi për OE i publikuar në ueb faqen e OSHP, sa i përket konfiskimit të tarifës së ankesës në këto raste të ngjashme të trajtimit të "palës pa interes" është bërë pasi që është parashtruar ankesa në OSHP.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Ministria e Shëndetësisë
- 1x1 OE "Internat Security Association" sh.p.k, me seli në Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.